



RAPORT STATISTIKOR JANAR-MAJ 2026

H y r j e

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të Tregut të sigurimeve dhe me pas të shoqërisë Insig sh.a për janar-maj 2026, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe për tregues specifikë të dhënat krahasohen për vitet nga 2022-2026.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë; Buletini Statistikor zyrtar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për janar-maj 2025 dhe të dhënat statistikore të përpunuara për periudhën në shqyrtim, të shoqërisë Insig Sh.a

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë Janar-Maj 2026.....	2
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës	3
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës	4
2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për Janar-Maj 2026	5
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve	6
2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike	7
2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës	8
2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	8
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për Janar -Maj 2026.....	9
3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike	9
3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit	10


1. Tregu i sigurimeve gjatë muajin Janar-Maj 2026

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-maj 2026 ka realizuar 10,569,158 mijë lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës, JoJetës dhe veprimtaria e risigurimeve duke shënuar rritje me 4.90% krahasuar me periudhën janar-maj 2025. Nga aktiviteti i Jo Jetës janë realizuar 9,571,705 mijë lekë prime duke shënuar një rritje me 4.89% dhe nga aktiviteti i Jetës janë realizuar 997,273 mijë lekë prime duke shënuar një rritje prej 5.50% , kurse veprimtaria e risigurimeve ka realizuar 179 mijë lekë duke shënuar një rënie prej 95.68%. Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve është 3,828,441 mijë lekë me një rritje prej 15.86% krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2025. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 92.95% e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 4.39% e tyre nga aktiviteti i Jetës dhe 2.66% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës


Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës është 9,571,705 mijë lekë duke shënuar rritje me 4.89% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ,ose 0.01% më pak sa rritja e tregut. Ndikimin kryesor në rezultatin e rritjes së përgjithshme të tregut krahasuar me janar-maj të vitit 2025, ka dhënë rritja të të gjitha klasat duke kryesuar me klasën Marinë, Aviacion e Transport me një rritje prej 47.65%,e ndjekur nga klasa e Përgjegjësiëve me 13.77% e me radhë klasat e tjera sipas grafikut 1.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar-maj 2026/2025




Duke ju referuar periudhës janar-maj për vitet 2022-2026 sipas grafikut 2, trendi i primeve rezulton me rritje nga viti në vit , nga ku viti 2026 shënon dhe vlerën më të lartë.

Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto tregu i sigurimeve, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)



Tregu vazhdon të dominohet nga klasa e Sigurimeve të Detyrueshme Motorike duke zotëruar 65.88% të totalit të primeve të shkruara bruto, e ndjekur më pas me rreth 11.98% nga sigurimet e Pronës ndërsa pjesa tjetër e ndarë midis klasave të tjera. Referuar grafikut 3, ku paraqitet raporti i sigurimeve vullnetare me ato të detyrueshme për periudhën janar-maj, për pjesa që sigurimet vullnetare zënë ndaj sigurimeve totale është më e madhe në periudhën janar-maj të vitit 2023 me 41.83% prime vullnetare ndaj totalit. Ndërkohë që raporti më i ulët paraqitet në periudhën janar-maj të vitit 2025 me 33.78%. Për periudhën raportuese raporti rezulton 34.12% me 65.88%.


Grafiku 3: Raporti vullnetare/totalit për periudhën janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)




Referuar sigurimeve të detyrueshme motorike, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë vetëm TPL rezultonë me rritje prej 5.63%, Kartoni Jeshil rezulton me rënie prej 1.73% dhe kufitarja me rënie prej 8.22%. Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jo Jetës gjatë periudhës janar-maj 2026 është 567,139 kontrata, duke shënuar një rritje prej 5.10% ose 27,510 kontrata më shumë se viti 2025.

Ndërkohë, norma e rritjes së tregut është rreth 4.89% krahasuar me janar-maj 2025 sipas grafikut 4, ndërsa raporti i sigurimeve vullnetare paraqitet në grafikun 5.

Grafiku 4: Norma e rritjes së primit, janar-maj 2026/2025




Grafiku 5: Raporti vullnetare/totalit, janar-maj 2026



1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës


Gjatë periudhës janar-maj 2026 nga aktiviteti i sigurimit të Jo Jetës janë paguar 3,558,504 mijë lekë dëme, duke shënuar një rritje me 18.77% ose 562,302 mijë lekë pagesa më shumë krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2025 dhe kjo shoqërohet edhe me rritjen e numrit të rasteve të paguara me 5.41% ose 1,612 raste më shumë.

Grafiku 6: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar-maj 2022-2026



Sipas grafikut 6, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është për periudhën janar-maj të vitit 2026. Gjatë kësaj periudhe nderkohe që rritet vlera e dëmeve të paguara rritet edhe numri i rasteve. Grafiku 7 paraqet, ndryshimin e dëmeve të paguara sipas klasave.

Grafiku 7: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, janar-maj 2026/2025




Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen nga lloji i sigurimeve Motorike rreth 80.12% e totalit, ndjekur nga Zjarri dhe Dëmtimet e Tjera në Pronë me 11.00%, Aksidentet dhe Shëndeti me 8.44% dhe Të tjera me 0.43%. Referuar të dhënave, raporti dëme/prime rezulton të jetë 37.18% për janar-maj 2026, afro 4.34% më shumë se raporti dëme/prime i vitit 2025.

2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Maj 2026

Aktiviteti i shoqërisë INSIG për periudhën janar-maj 2026 për Tregun e Sigurimeve të Jo Jetës, u mbyll me një rezultat primesh të shkruar bruto prej 636,933 mijë lekë, duke shënuar **një rritje prej 2.84%** ose 17,594 mijë lekë më shumë krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2025. Krahasuar me janar-maj nga vitet 2022-2026, ecuria e primeve të shoqërisë Insig është në rritje nga viti në vit, duke shënuar vlerën më të ulët në vitin 2022, dhe vlerën më të lartë të primeve të realizuara në vitin 2026, paraqitur grafiksht si më poshtë në grafikun 8.


Grafiku 8: Ecuria e primeve të shkruara bruto Insig, janar-maj 2022-2026



Raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit për periudhën janar-maj të vitit 2026 është 11.38% me 88.62%, duke shënuar një rritje në përqindje prej 1.03% të këtij raporti krahasuar me të

njëjtën periudhë të vitit 2025, ku raporti i vullnetareve ndaj totalit ishte 10.35%. Ecuria e këtij raporti për periudhën janar-maj nga 2022-2026, paraqitet sipas grafikut 9.


Grafiku 9: Prime vullnetare ndaj totalit Insig, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)



2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Aksidenteve e Shëndetit

Gjatë periudhës janar-maj të vitit 2026 nga klasa e sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit janë realizuar 3,041 mijë lekë prime të shkruara bruto duke shënuar një rritje me 7.91% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Primet e realizuara nga ky grup në raport me totalin zënë 0.48% e tyre. Grafiku 10, ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për periudhën janar-maj nga vitit 2022–2026. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet për vitin 2025, ndërsa më e larta për vitin 2023.

Grafiku 10: Primet e shkruara bruto klasa e aksidenteve e shendetit Insig, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)




2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike

Në klasën e sigurimeve motorike, përfshihen sigurimet e detyrueshme motorike Tpl, Karton Jeshil, Kufitare dhe sigurimet vullnetare motorike, Kasko. Nga klasa e sigurimeve motorike shoqëria Insig për periudhën janar-maj të vitit 2026 ka grumbulluar 607,294 mijë lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar rritje me 4.21% Vetëm nga sigurimet e detyrueshme motorike primet e shkruara bruto janë 564,446 mijë lekë, të cilat përbëjnë rreth 92.84% të gjithë primeve


të klasës motorike. Nga sigurimet e detyrueshme motorike Tpl zë pjesën më të madhe dhe krahasuar me 2025 ka një rritje 4.75%, Kartoni Jeshil ka një rënie me 1.38% ndërsa Kufitare ka një rënie me 8.40%. Ndërkohë për periudhën janar-maj 2026, primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko janë 42,848 mijë lekë, duke shënuar një rritje me 12.42% krahasuar me vitin 2025. Primet e kësaj klase zënë 7.06% të totalit të motorikeve. Primet e realizuara nga sigurimet motorike, bëjnë pjesën më të madhe të totalit të primeve të INSIG, duke zënë respektivisht 95.35% të tij. Për periudhën janar-maj të viteve nga 2022–2026 trendi i primeve të sigurimeve të detyrueshme motorike është në rritje, ku vlera më e ulët shënohet për janar-maj e vitit 2022 dhe vlera më e lartë në janar-maj të vitit 2026, sipas grafikut 11.

Grafiku 31: Ecuria e primeve - klasa e sigurimeve motorike të detyrueshme Insig, janar-maj 2022 - 2026 (mijë lekë)



Trendi i primeve të realizuara për sigurimet Kasko, është i luhatshëm duke parë ecurinë për periudhën janar-maj nga 2022-2026, ku vlera më e ulët shënohet në vitin 2022 dhe vlera më e lartë në vitin 2024, sipas grafikut .12

Grafiku 42: Ecuria e primeve Insig – klasa e sigurimeve kasko, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)




2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës

Në klasën e sigurimeve të Pronës sipas të dhënave të AMF-së, përfshihen përveç sigurimeve nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtime të tjera në Pronë edhe sigurimet e punimeve në ndërtim si CAR apo dhe EAR. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-maj të vitit 2026 është 10,359 mijë lekë, duke shënuar rënie prej 30.54% krahasuar me janar-

maj të vitit 2025. Në raport me totalin e primeve të INSIG për periudhën janar-maj të vitit 2026, kjo klasë zë 1.63% të primeve totale të vetë shoqërisë. Ecuria e primeve bruto të kësaj klase për periudhën janar-maj nga 2022-2026 paraqitet në grafikun 13 , ku vihet re që vlera më e ulët i takon vitit 2026 dhe vlera më e lartë arrihet në vitin 2023.


Grafiku 53: Ecuria e primeve Insig - klasa e sigurimeve të pronës, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)



2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Në klasat e sigurimeve të tjera përfshihen llojet e sigurimeve të Garancive, Mallrave në Transport, Përgjegjësi, Aviacionit dhe Marinës. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-maj të vitit 2026 është 16,239 mijë lekë. Në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar-maj të vitit 2026, ky grup realizon 2.55% të totalit. Sigurimi i Garancive zë peshën më të madhe në këtë grup, i ndjekur nga sigurimet e Përgjegjësi dhe m pas klasat e tjera sipas grafikut 14.

Grafiku 64: Ecuria e primeve Insig për klasat e tjera, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)




Klasa te Tjera,	2022	2023	2024	2025	2026
Sigurimi i garancive	6,552	4,336	5,492	4,296	7,560
Sigurimi mall në transport	56	0	74	9	0
Sigurimi i përgjegjësi	22,890	26,939	8,060	13,344	6,138
Sigurimi i avacionit	0	0	0	0	0
Sigurimi i marinës	3,791	2,484	1,125	1,219	2,541

3.Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar -Prill 2026

Për periudhën janar-maj 2026, totali i dëmeve të paguara nga shoqëria INSIG është 175,083 mijë lekë pagesa përfshirë edhe shpenzimet për trajtimin e dëmeve, duke shënuar një **rënie me 17.71%**, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025. INSIG renditet në vend të fundit në treg duke paguar rreth 4.92% të totalit të dëmeve të tregut. Numri i dëmeve të paguara ka rënë me **9.34%**, ose 98 raste më pak krahasuar me vitin 2025.


Grafiku 15: Pjesa e dëmeve të paguara nga llojet e sigurimit Insig, janar-maj 2025



Për INSIG, vlera me e madhe e pagesave për periudhën janar-maj 2026 i takon sigurimeve motorike që zënë 99.77% të totalit të pagesave, më pas vjen Prona me 0.23% të pagesave. Klasat e tjera nuk kanë raportime për këtë periudhë. Më sipër grafiku 15, paraqitja grafike e peshës specifike të pagesave, për periudhën janar-maj 2026.

Duke ju referuar ecurisë së pagesave në vite vihet re që, për periudhën janar-maj nga viti 2022-2026, kemi një luhatje pagesash. Janar-maji i vitit 2025, shënon vlerën më të lartë të pagesave, ndërsa viti 2023 shënon raportin më të lartë të dëmeve të paguara ndaj primeve të realizuara prej 35.10%. Për janar-maj 2026 raporti dëme/prime është 27.49%, sipas grafikut 16.

Grafiku 16: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig, janar-maj 2022-2026 (mijë lekë)




3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike

Sigurimet motorrike për periudhën janar-maj 2026, kapin vlerën prej 174,688 mijë lekë ose 99.77% të totalit të pagesave. Nga karahasimi me periudhën janar-maj të vitit 2025, kemi një rënie prej rreth 17.07%. Brenda grupit 9.08% e pagesave i takon sigurimit motorik vullnetar Kasko dhe pjesa tjetër prej 90.92% i takon pagesave për sigurimet e detyrueshme motorike ku, Tpl zë 84.22%, Kartoni Jeshil 5.89% dhe Kufitare 0.82%. Referuar karahasimit me periudhën janar-maj të vitit 2025, TPL rezulton me rënie pagesash prej 17.03%, Kartoni Jeshil rezulton me rënie prej 24.71%, Kufitare me rritje prej 56.49% dhe Kasko rezulton me rënie prej 15.41 %.

3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit

Nga klasa e sigurimit të Pronës kemi pagesa vetëm për janar-maj 2026 prej 395 mijë lekë. Nga klasa e Garancive, klasa e Përgjegjësisë dhe klasa e Aksidenteve dhe Shëndetit nuk kemi raportime dëmsh për këtë periudhë. Grafiku 17 më poshtë, ecuria e pagesave për periudhën janar-maj 2025-2026 dhe ndryshim në përqindje sipas klasave të sigurimeve.

Grafiku 17: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje Insig, janar-maj 2025-2026 (në mijë lekë)



D.Paguara	TPL	Karton Jeshil	Kufitare	Kasko	Aksid, &Shend,	Prona	Garanci	Pergjegjesi
2025	177,321	13,654	917	18,744	2,126	-	-	0
2026	147,116	10,281	1,435	15,856	-	395	-	0
Ndysh.%	-17.03%	-24.70%	0.00%	-15.41%	-100.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Burimi: AMF & INSIG

